



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 08-332

13.12.2024

Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit në radio nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir, nr.ynë ark.08-4697/1 datë 18.11.2024, deklaratën, nr.UZP 8584/2024 datë 28.11.2024, nr.ynë ark.08-4697/3 datë 04.12.2024, nga themelues i vetëm/pronar i transmetuesit dhe konkluzionin me ark.nr.02-5070/3 datë 12.12.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 45-të mbajtur më 12.12.2024 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir, është posedues i lejes për transmetim në radio, PA1 nr.08-87 datë 07.09.2023, që transmeton program përmes transmetuesi tokësor, në nivel lokal në zonën e Komunës së Manastirit, shërbim programor-radio folëse muzikore me format të përgjithshëm, në gjuhën maqedonase.

Më datë 18.11.2024 Shoqëria Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir, drejtuar Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) dorëzoi njoftimin (nr.ynë ark.08-4697/1 datë 18.11.2024), se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir, për shkak të rrethanave private të paraqitura (vdekja e drejtuesit) dhe gjendjes së rëndë financiare nuk ka mundësi më shumë të transmeton program në radio. Me rastin e njoftimit në fjalë, Agjencia me datë 19.11.2024, me Shkresë, nr.ynë ark.08-4697/2, njoftoi transmetuesin në fjalë se në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) është e nevojshme të dorëzon deklaratë të noterizuar nga themeluesi i vetëm/pronari i radiodifuzerit, në të cilën detyrimisht duhet të ceket se radiodifuzeri Shoqëria Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir, ndërprehen me ritransmetim të programeve në radio, duke paraqitur datën e saktë të ndërprerjes me transmetim të programit në radio. Njëkohësisht, radiodifuzeri është njoftuar se me dorëzimin e kërkesës së kërkuar të noterizuar do të përmbush kushtin ligjor, që Agjencia të miraton Aktvendim për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve – të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir.

Më datë 04.12.2024 drejtuar Agjencisë nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir, është dorëzuar deklaratë nr. UZP 8584/2024 datë 28.11.2024 e noterizuar (nr.ynë ark.08-4697/3 datë 04.12.2024), nga themeluesi i vetëm/pronar i radiodifuzerit – Marija Mladenovska - Dimitrovska, se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir, më datë 14.11.2024 ndërprehen me ritransmetim të programit në radio.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, leja për transmetim në radio ndalon së vlefshmi sipas fuqisë ligjore me deklaratë me shkrim të zotëruesit, me të cilën njofton

Agjencinë për ndërprerjen me transmetim të programit në radio. Për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio ose televizion sipas fuqisë ligjore Këshilli nuk miraton vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse lejes i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi (2) të LSHMAAV).

Rrjedhimisht nga sa mësipër, dhe në bazë të nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, si dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim të lartpërmendur nga themelues i vetëm/pronar i transmetuesit (e noterizuar), janë plotësuar kushtet ligjore për ndalimin e vlefshmërisë sipas fuqisë ligjore, sipas së cilës Agjencia do të fshijë transmetuesin Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir nga regjistri i transmetuesve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele me nr.ark.01-3732/1 datë 29.07.2019 njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit në radio nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive B - 97 SHPKNJP Manastir, nr.ynë ark.08-4697/1 datë 18.11.2024, daklaratën nr. UZP 8584/2024 datë 28.11.2024 (nr.ynë ark.08-4697/3 datë 04.12.2024) nga themelues/pronar i vetëm i transmetuesit dhe konkluzionin me ark.nr.02-5070/3 datë 12.12.2024, është marrë aktvendim si në dispozitiv, i cili hyn në fuqi menjëherë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.